

30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Fq. 2

Pirateria në internet, AMA nis turin e diskutimeve me subjektet në të gjithë qarqet e vendit




Fq. 2

Memorandum Bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Polonisë. Një urë e re ndërveprimi mes dy vendeve

Berati ishte ndalesa e parë e turit të tryezave të diskutimit të nisur nga AMA ...

DËRGO ANKESË PËR TIKTOK



Transparençë AMA-TikTok, bilanci për videot e bllokuara

Vazhdon bashkëpunimi me qytetarët dhe platformën TikTok për denoncimin dhe bllokimin e përmbajtjeve të dëmshme në këtë platformë. Deri tani janë shqyrtuar...

AMA vazhdon fushatën "Fol Shqip", për pastërtinë e gjuhës

Autoriteti i Mediave Audiovizive vazhdon fushatën "Fol Shqip" duke monitoruar përdorimin e fjalëve të huaja në mediat audiovizive me qëllim ruajtjen e pastërtisë së ...

| FJALË TË HUAJA TË PËRDORURA | ZGJEDHJE E MUNDSHME PËR ZËVENDËSIM |
|-----------------------------|------------------------------------|
| ✗ GOSIP (GOSSIP) | ✓ THASHETHEME |
| ✗ BET (BET) | ✓ BASTE |
| ✗ AMBIGUE | ✓ E PAQARTË |
| ✗ MEDIKAMENTE | ✓ BARNA |
| ✗ PRIMARE | ✓ PARËSORE |
| ✗ PERMANENT | ✓ I PËRHERSHËM |
| ✗ VERSION | ✓ VARIANT |

Fq. 2



Fq. 3

Gazetarët e rinj të Kosovës vizitë në AMA

Në kuadër të Programit për Median, mbështetur nga Misionin e OSBE-së në Kosovë një grup gazetarësh të rinj nga Kosova kanë zhvilluar një bashkëbisedim interesant në ambientet e AMA-s, mbi sfidat që paraqet për të dyja palët media dhe rregullat....

Memorandum Bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Polonisë. Një urë e re ndërveprimi mes dy vendeve

Nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit mes rregullatorëve të Shqipërisë dhe Polonisë. Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi dhe Z. Maciej Swirski, Presidenti i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit Polak (KRRIT), theksuan rëndësinë e këtij bashkëpunimi si hap të rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve mes dy institucioneve rregullatore për përmirësimin e tregut mediatic. Memorandumi fokusohet në matjen e audiencës, edukimin mediatic,



hulumtimin e opinionit publik dhe monitorimin e përmbajtjeve audiovizive. Kryetarja Krasniqi theksoi rëndësinë e bashkëpunimit për luftën kundër dezinformimit dhe promovimin e edukimit mediatic, ndërsa Presidenti i KRRIT, Z. Swirski, deklaroi gatishmërinë për një bashkëpunim të qëndrueshëm që do të përmirësojë cilësinë e gazetarisë në median audiovizive. [Lexo më shumë](#)



Krasniqi në forumin e organizuar nga kryetarja e Kuvendit, me drejtuesit e institucioneve të pavarura



Në forumin e organizuar nga Kryetarja e Kuvendit, Znj. Elisa Spiropali, me drejtuesit e institucioneve të pavarura, Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, prezantoi pikat kryesore të punës së institucionit. Krasniqi theksoi se AMA është në fazën përfundimtare të konsultimit publik për ndryshimet në ligjin organik të AMA-s dhe se këto propozime do të paraqiten së shpejti në Kuvend për miratim. Ndryshimet synojnë përmirësimin e rregullimit të tregut audioviziv dhe forcimin e masave kundër piraterisë. Gjithashtu, ajo nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërsektorial.

[Lexo më shumë](#)

AMA vazhdon fushatën "Fol Shqip" për pastërtinë e gjuhës

Autoriteti i Mediave Audiovizive vazhdon fushatën "Fol Shqip" duke monitoruar përdorimin e fjalëve të huaja në mediat audiovizive me qëllim ruajtjen e pastërtisë së gjuhës shqipe. AMA sjell raste të përditësuara të përdorimit të tyre duke ofruar përmes gjuhëtarëve forma korrekte për të ndihmuar punonjësit e mediave që të shmangin përsëritjen e tyre. [Lexo më shumë](#)

Monitorimet e muajit shtator, lajmet politike zënë vendin kryesor në edicione

Lajmet politike kanë zënë vendin kryesor në edicionet e lajmeve në televizionet kombëtare gjatë muajit shtator. Ato kryesojnë me 16.68% të përmbajtjes së edicioneve të ndjekura nga lajmet sociale me 12.53%. Edhe në shtator lajmet ndërko-mbëtare kanë një vend të rëndësishëm në edicionet e lajmeve, me 12.43%. Monitorimet i përkasin periudhës nga 01.09.2024 deri më 30.09.2024.

[Lexo më shumë](#)

Pirateria në internet, AMA nis turin e diskutimeve me subjektet në të gjithë qarqet e vendit

Berati ishte ndalesa e parë e turit të tryezave të diskutimit të nisur nga AMA për të luftuar piraterinë në internet. Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi, gjatë takimit në Berat, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me operatorët kabllorë të ligjshëm për të ndaluar transmetimet pirate nga ISP-të e paautorizuara. "Ndryshimet ligjore që kemi hedhur prej kohësh në konsultim publik, së shpejti do t'i çojmë në Kuvend"- u shpreh Krasniqi. Nga ana tjetër, subjektet kabllorë e pritën me optimizëm dispozitën që parashikon ndërprerjen e transmetimeve pirate brenda 30 minutave dhe nëse subjekti nuk reagon shndërrohet në shkelës/bashkëshkelës i ligjit 97/2013. Tryezat e diskutuara në Berat, Elbasan dhe në Vlorë u mirëpritën nga operatorët, të cilët u angazhuan të mbështesin këtë luftë. Turi do të vijojë në të gjitha qarqet për të forcuar zbatimin e ligjit në tregun audioviziv.

[Lexo më shumë](#)

Transparencë AMA - TikTok, bilanci për videot e bllokuara

Vazhdon bashkëpunimi me qytetarët dhe platformën TikTok për denoncimin dhe bllokimin e përmbajtjeve të dëmshme në këtë platformë. Deri tani janë shqyrtuar 400 ankesa të ardhura në AMA nga të cilat 112 janë vlerësuar në shkellje të ligjit. Nga këto, 109 video/audio janë hequr nga platforma dhe 3 të tjera janë në shqyrtim. Ndërkaq për pirateri janë raportuar 865 video të nga të cilat 829 janë hequr nga platforma, 121 profile janë mbyllur, dhe 36 janë në proces. AMA inkurajon qytetarët të raportojnë çdo përmbajtje që ata e gjykojnë të dëmshme.

[Lexo më shumë](#)



Gazetarët e rinj të Kosovës vizitë në AMA

Në kuadër të Programit për Median, mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, një grup gazetarësh të rinj nga Kosova kanë zhvilluar një bashkëbisedim interesant në ambientet e AMA-s, mbi sfidat që paraqet për të dyja palët - media dhe rregullatorë - zhvillimi i teknologjisë.

Ata u njohën dhe me mënyrën se si funksionon AMA, rregullimin e tregut audio dhe audioviziv, ligjin mbi të cilin mbështetet dhe bashkërregullimin e tij si kërkesë e kohës.

[Lexo më shumë](#)